



## Komuna e Prishtinës

### RAPORTIM

Drejtoria	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm
Periudha raportuese	Prill 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

### PËRMBLEDHJE

*Të shkruhet shkurtimisht një përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.*

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm gjatë muajit prill 2018, ka vazhduar t'i kryejë punët dhe detyrat sipas planit të paraparë

### AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

#### **Sektori i planifikimit strategjik:**

- Mbajtja e trajnimit të stafit në "Gis" dhe SPAK, lidhur me kontratën "Modernizimi i procedurave të Planifikimit Hapësinor në Prishtinë" me IRUSP/NIRAS;
- Konsolidimi i grupit punues dhe për PZHK dhe HZK;
- Mbajtja e takimit me përfaqësues (grupit punues) lidhur me SUMP;
- Mbajtja e takimit lidhur me projektin "Fuqizimi i së drejtës ndaj qytetit për të gjithë", UNHABITAT dhe përfaqësues nga drejtoritë komunale;
- Propozimet për lokacionin e Rezidencës britanike dhe Ambasadën (prietet kërkesa zyrtare nga Ambasada britanike, propozimet);
- Punëtorja, vlerësimi i projektpropozimit për ndërtimin e kompleksit ndërtimor me kosto të përballueshme;
- Vazhdimi i punëtorisë për rrugën A;
- Takime me palë, të martave dhe të enjteve, nga ora 09:00 deri ne 12:00.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Ngarkesa e bizneseve me taksë komunale, në bazë të Rregullores për ngarkesë dhe gjobë komunale;
- Dhënia e vërtetimeve për biznese që nuk kanë obligime;
- Dhënia e lejeve për biznese dhe transport;
- Vazhdimi i lejeve të punës për "Auto-Taxi".

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efecientë**

- Nënshkrimi i Kontratës për tenderin e shënimit Ditët Mjedisore;
- Manifestimi i Ditës së Tokës, 22 prill;
- Takim me bizneset të cilat kanë përkrahur organizmin Dita e Tokës;
- Takim me përfaqësues nga organizata joqeveritare "Fondacioni Jeshil", për zbatimin e një projekti mjedisor të përbashkët me REC, për ndërtimin e një kopshti të qelqtë të gjelbër;
- Përgatitja e detyrës projektuese për dizajnimin e fletushkave "Vlerat natyrore të biodiversitetit";
- Aktivitetet mjedisor më 5 qershor, Dita Botërore e Mjedisit dhe më 22 shtator, Dita e Qyteteve pa Makina.

## **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA**

### **Sektori i planifikimit strategjik**

*Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga sektori juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Gjatë muajit raportues janë realizuar këto punë:

- Mbajtja e punëtorisë në objektin e ri të Komunës "Reflektimi kolektiv rreth zonës për auditimin e sigurisë dhe identifikimi i grupeve të interesit ", mbështetës UNHABITAT, më 02.04.2018.
- Takim me zyrtarët nga Drejtoria e Investimeve Kapitale, lidhur me pesë projektet e shkollave të planifikuara;
- Takim me prodekanen e Fakultetit Teknik të Prishtinës, znj. Vjollca Komoni, lidhur me lokacionin e propozuar për FSHMN;
- Takim me Zyrën ligjore lidhur me lëndën 04-945/02-75137;
- Kontrollimi i planeve rregulluese të unifikuara në CAD - sisteme me ato të miratuara nga KK;

- Takim me UN HABITAT, zyrtarët nga drejtoritë e Komunës dhe Policinë e Kosovës, lidhur me lokacionin e përzgjedhur për vazhdim të projektimit të hapësirës publike;
- Analizë e lokacionit për ndërtesën e sigurisë së Ambasadës amerikane;
- Takim me përfaqësues nga IRUSP/NIRAS për finalizimin e materialit për fillimin e hartimit të HZK-së;
- Takim me zyrtarë nga Ambasada britanike, lidhur me caktimin e lokacionit për ndërtimin e Rezidencës Britanike dhe caktimin e lokacionit për ndërtimin e Ambasadës;
- Takim me drejtorin e Drejtorisë së Pronës dhe zyrtarë nga Zyra për regjenerim urban, lidhur me lokacionin e shkollës në Prishtinën e Re - Zona Perëndim;
- Takim me Zyrën ligjore lidhur me Hartën zonale komunale - afatet kohore;
- Studim dhe analizë e PZHK-së aktuale;
- Takim me SUMP;
- Takim me GIZ lidhur me planin e implementimit të SUMP- hapat e mëtutjeshëm;
- Takim me përfaqësues nga IRUSP/NIRAS, për finalizimin e materialit për fillimin e hartimit të HZK-së;
- Takim me zyrtarë nga Zyra për regjenerim urban, lidhur me lokacionin e këndeve të librave;
- Takim -prezantim lidhur me kompleksin e ndërtesave me kosto të përballueshme;
- Takim me Drejtorinë e Pronës dhe zyrtarë nga Zyra për regjenerim urban, lidhur me lokacionin e shkollës në Prishtinën e Re - Zona Perëndim;
- Takim i dytë me Zyrën ligjore, lidhur me Hartën zonale komunale - afatet kohore;
- Studim dhe analizë e PZHK-së aktuale;
- Analiza dhe dhënia e komenteve lidhur me 2 raportet e fundit (2 dhe 2b) të dërguara nga SUMP;
- Takim me përfaqësues nga IRUSP/NIRAS, për finalizimin e materialit për fillimin e hartimit të HZK-së;
- Takim i radhës me zyrtarë nga Zyra për regjenerim urban lidhur me lokacionin e këndeve të librave;
- Takim -prezantim lidhur me kompleksin e ndërtesave me kosto të përballueshme;
- Takim me OJQ-në dhe regjisorin e dokumentarit për Rexhep Lucin;
- Takim me zyrtarët e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe pronarët e parcelave ku shtrihet kolektori në lagjen "Kalabria";
- Takim me drejtorin dhe zyrtarët e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, lidhur me shkollën "Don Bosko" në lagjen "Kalabria";

- Takim me UN HABITAT, zyrtarët nga drejtoritë e Komunës dhe Policinë e Kosovës, lidhur me projektin e Parkut të qytetit;
- Prezantimi i Planit të mobilitetit – SUMP në takimin me përfaqësuesit nga Hekurudhat e Kosovës dhe përfaqësues nga Komuna, diskutimi lidhur me projektin e mundësisë së funksionalizimit të linjave hekurudhore, si ato: Prishtinë – Podujevë, Prishtinë – Aeroport, si dhe mundësia e realizimit të mbi ose nënkallimit që e lidhë stacionin aktual të trenit me lagjen “Arbëria 3”;
- Takimi informues për komunitetin lidhur me lokacionin e përzgjedhjes për Ecjen e Auditimit të Sigurisë për Parkun e Qytetit;
- Vizitë në terren: Vlerësimi i sigurisë në parkun e qytetit, ecja nga ora 19:00 – 22:30, dt.26.04.2018 dhe 8:30 – 12:00, dt.27.04.2018;
- Takim me zyrtarë nga Drejtoria e Urbanizmit, lidhur me projektin për banimin me kosto të përballeshme;
- Rruga “A” , diskutim me drejtorët dhe zyrtarët komunalë lidhur me realizimin dhe shtrirjen e rrugës “A”, që lidh Zllatarin, Matin, Prishtinën e Re, si dhe lagjen “Kalabria”, formimi i grupit punues;
- Punëtorja “Analiza e shtrirjes së rrugës “A”, lidhur me pronësinë, koston e shpronësimit dhe koston e realizimit-ndërtimit;
- Takim me zyrtarët nga KFOR-i, lidhur me vendosjen e obeliskut të NATO-së”;
- Përgatitja e materialit dhe vizita në terren lidhur me vendosjen e obeliskut të NATO-së”, (arsyetimi, vendimi, certifikata e pronësisë) për Kuvendin e Komunës;
- Takim me UN HABITAT, zyrtarët nga drejtoritë e Komunës, Policinë e Kosovës, qytetarët, si dhe grupet e ndryshme të interesit, lidhur me ecjen dhe auditimin e zonës së përcaktuar me projektin “ Fuqizimi i të drejtës ndaj qytetit për të gjithë –Parku i Qytetit;
- Mbajtja e takimeve me palë (punë në vazhdimësi);
- Identifikimi i problemeve/vështirësive (rasteve) gjatë implementimit të planeve;
- Dhënia e informatave nga plani dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me fushën e planifikimit (punë në vazhdimësi );
- Lëshimi i informatave nga sistemi online ( punë në vazhdimësi );
- Mbajtja e takimeve me palë (punë në vazhdimësi).

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Janë dhënë 204 vërtetime për persona fizikë që nuk ushtrojnë aktivitet biznesi;
- Janë dhënë 2 vërtetime për biznese që nuk ngarkohen me taksë komunale;
- Janë bërë 10 kontrole të bizneseve për pagesë të taksës komunale;
- Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste – 11;

- Kërkesë për ndërrim të automjetit dhe vazhdim të lejeve për "Auto-Taxi" - 19;
- Krekës për leje "Auto-Taxi" - 2;
- Leje në procedurë - 8.

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë**

- Manifestimi i Ditës Botërore të Tokës, 22 prill, aktivitete të ndryshme, mbjellje të drurëve, pastrim;
- Takimi me përfaqësuesit e universiteti "Hasan Prishtina" për pastrimin dhe mbjelljen e drurëve në Kampusin e Universitetit për renditje dhe bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës për projektet e mjedisit;
- Takimi me ekspertë mjedisorë të angazhuar për pjesën e mjedisit të Planin i Mobilitetit, nga kompania "Mot Macdonals" me të cilin diskutuam për të dhënat e mjedisit në plan, të cilat nuk janë reale dhe nuk përkojnë me gjendjen në Prishtinë;
- Takimi me përfaqësues të "Agrocoop", e cila ka dhuruar 500 lule për Ditën e Tokës;
- Mbjellja e drurëve nëpër pjesët e qytetit;
- Takimi me grupin punues për hartimin e "Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale";
- Fillimi i fazës së dytë të projektit të JICA për kontrollin e ndotjes së ajrit, së bashku me MMPH-në;
- Mbikëqyrje e kontratës me Hortikulturën për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese në qytetin e Prishtinës;
- Rregullimi i hapësirave të degraduara në qytet;
- Përfundimi i projektraportit të auditimit "Mekanizmat institucionalë për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit";
- Takimi në MMPH për Ditën Botërore të Biodiversitetit.

## **AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

### **Sektori i planifikimit strategjik**

- Plani i mobilitetit (SUMP) është në procedurë.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm:**

- Pagesa e taksave komunale për veprimtari biznesi;
- Vazhdimi i lejeve të punës për biznese;

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë**

- Aktivitetet mjedisore, 5 qershor - Dita Botërore e Mjedisit, 22 shtator - Dita e Qyteteve pa Makina''.

## STATISTIKAT

*Shënimi, dhe ku është e nevojshme shpjegoni, të gjitha statistikat përkatëse për sektorin tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas se detyrave të sektorit tuaj.*

## BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE AI I SHPENZUAR PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

### Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm:

- Janë planifikuar për këtë periudhë 8.500,00 €;
- Janë realizuar 5.300,00 €.

## TAKIMET ME PALË

### Sektori i planifikimit strategjik

- Kanë vazhduar takime të shumta në ditët e caktuara me palë.

### Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm

- Janë realizuar disa takime me palë-grupe të interesit, kryesisht nga komuniteti i biznesit.

### Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë

- Kanë vazhduar takime të shumta në ditët e caktuara me palë.

## TAKIMET ME INSTITUCIONET TJERA

### Sektori i planifikimit strategjik:

- Gjithashtu janë organizuar edhe takime të ndryshme me institucionet.

### Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm

- Koordinimi i aktiviteteve me MTI-në dhe komunat e rajonit të Prishtinës, për ngritjen e nivelit të aplikimit për kategorizimin e objekteve akomoduese, si dhe sensibilizimin e operatorëve të kësaj fushe për kategorizim.

- Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë

Gjithashtu, janë organizuar edhe takime të ndryshme me institucionet.

## DISKUTIME PUBLIKE/TAKIMET ME QYTETARË

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

### Sektori i planifikimit strategjik

Prill 2018		
nr.	Përshkrimi i lëndës	Numri i lëndëve të trajtuara
1	Aktpërcjellës	
2	Kërkesa për nivelin lokal dhe qendror	
3	Informime nga Plani (PZHU, PRRU)	55
4	Caktim i vijës rregulluese	
5	Komisione	
6	Leje mjedisore komunale	3
7	Shqyrtime publike	
8	Pëlqime për bashkim të parcelave	4
9	Parcelizime- informime	3
10	Pëlqime të ndryshme (mjedisor/renovim/rrethojë)	
11	Kontrollim të projekteve	
12	Plotësime dokumentacioni	
13	Refuzime	
14	Mbikëqyrje të projekteve	
15	Tërheqja e lëndës nga pala	
16	Arsyetime për Kuvendin e Komunës dhe kërkesa të tjera	
17	Detyra projektuese	
18	Mbikëqyrje të planeve rregulluese	
19	Mbikëqyrje të projekteve ( p.sh. incizime gjeodezike )	
20	Kërkesa online	44
21	Gjithsej numri i lëndëve të pranuar në këtë periudhë	67 + 44
22	Gjithsej numri i lëndëve të trajtuara në këtë periudhë	106
23	Numri i lëndëve në trajtim e sipër	5

### Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm

- Janë pranuar gjithsej 226 kërkesa dhe të gjitha janë të kryera.
- Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë

Prill 2018

nr.	Përshkrimi i lëndës	Numri i lëndëve të trajtuara
1	Aktpërcjellës	
2	Kërkesa për nivelin lokal dhe qendror	
3	Informime nga Plani (PZHU, PRRU)	
4	Caktim i vijës rregulluese	
5	Komisione	
6	Leje mjedisore komunale	11
7	Aktvendime për kompensim	10
8	Pëlqime për bashkim të parcelave	
9	Parcelime- informime	
10	Pëlqime të ndryshme (mjedisor/renovim/rrethojë)	1
11	Kontrollim të projekteve	
12	Plotësime dokumentacioni	
13	Refuzime	
14	Mbikëqyrje të projekteve	
15	Tërheqja e lëndës nga pala	
16	Arsyetime për Kuvendin e Komunës dhe kërkesa të tjera	
17	Detyra projektuese	
18	Mbikëqyrje të planeve rregulluese	
19	Mbikëqyrje të projekteve (p.sh. incizime gjeodezike )	
20	Lëndë të shqyrtuara nga Komisioni për LMK	8
21	Gjithsej numri i lëndëve të pranuar në këtë periudhë	8
22	Gjithsej numri i lëndëve të trajtuara në këtë periudhë	
23	Numri i lëndëve në trajtim e sipër	7

## SFIDAT

### **Sektori i planifikimit strategjik**

*Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda sektorit, Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

- Mungesa e stafit me profil adekuat.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

Duhet të ndërhyhet në programin ekzistues, gjegjësisht të freskohen të dhënat për biznese.



## REKOMANDIME

### Sektori i planifikimit strategjik

- Rekomandoj që gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit, të hartohet strategjia e shpronësimit, të definohet saktë, çoftë me rregullore ose vendim. Incizimet satelitore (Ortofoto 2018) për Komunën e Prishtinës, me ç'rast do të kemi pasqyrën e qartë dhe gjendjen faktike të ndërtuar në Komunën e Prishtinës;
- Rekomandoj që për vitin 2018, arkivi digjital i planifikimit, gjegjësisht planet hapësinore të mbrohen në atë mënyre që mos të jenë të edituar nga secili zyrtar, në kuadër të kësaj të pajisemi edhe me licenca të AutoDeskut;
- Rekomandoj që për vitin 2018, të kemi vizita profesionale jashtë vendit, apo trajnime të ndryshme profesionale, përmes të cilave do të kemi mundësi të bëjmë shkëmbim të përvojave nga lëmi i planifikimit.

*Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.*

- Të rritet numri i profesionistëve brenda Drejtorisë;
- Të bëhen disa trajnime të duhura;
- Të mund të bëhen hulumtime më shumë rreth zgjidhjeve urbane.

### Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efecientë

- Rekomandoj që për vitin 2018, të kemi vizita profesionale jashtë vendit, apo trajnime të ndryshme profesionale, përmes të cilave do të kemi mundësi të bëjmë shkëmbim të përvojave nga lëmi i mjedisit.

## AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

*Listoni aktivitetet e planifikuara për sektorin tuaj për muajin pasues.*

### Sektori i planifikimit strategjik

- Fillimi i hartimit të Plani zhvillimor komunal, përgatitjet;
- Fillimi i hartimit të Hartës zonale komunale, përgatitjet.

### Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm

- Vlerësimi i aplikacioneve dhe verifikimi i plotësimit të kritereve të përcaktuara nga organi përkatës komunal.

- Shqyrtimi i lëndëve të pranuar në terren;
- Pagesa e taksave komunale për biznese;
- Lëshimi i lejeve për biznese.

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë**

- Vazhdimi i pjesës së dytë të projektit “Inventarizimi i ndotësve të ajrit”.